



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**REKK** REGIONAL CENTRE  
FOR ENERGY  
POLICY RESEARCH



National  
Association of  
Regulatory  
Utility  
Commissioners

# Karakteristikat kryesore të komisioneve rregullative

nga prof. V.Jankauskas

prezantuar gjatë

Punëtorisë së NARUC/ERRA mbi Rregullimin e  
Kompanive të Shërbimeve Publike në Ekonomi të  
Tregut

14-16 prill 2008, Prishtinë



Center for  
Energy and Natural Resources

- Çka është rregullimi i pavarur i energjisë
- Cilat janë kushtet kryesore për rregullatorët
- Lindja dhe zhvillimi i rregullatorëve të energjisë në shtetet e BE-së
- Kërkesat për rregullatorët, sipas Direktivave të BE-së për Energji Elektrike dhe Gas
- Zhvillimi i mëtejshëm i agjencive rregullative në BE

# Rregullimi i pavarur i energjisë

May 23, 2008

# Rregullatorët e pavarur

- Rregullimi i energjisë - pse?
- Rregullimi i energjisë – si?
- Rregulatori i pavarur– pse?

- Qeveria ka 3 funksione: tatimimin, shpenzimin dhe rregullimin
- Rregullimi është intervenim i Qeverisë
  - I drejtpërdrejtë: legjislacioni primar e sekondar
  - I tërthortë: thirrje telefonike, këshilla shoqërore, favore personale, etj
- Rregullimi ekonomik paraqet një zëvendësim (të keq) për konkurrencën

- Mbrojtja e konsumatorëve
- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të kompanive
- Promovimi i konkurrencës
- Mbledhja dhe shpërndarja e informatave

# Si të rregullohet?


- Pa rregullim
- Vetë-rregullim
- Komandim dhe kontroll
- Rregullim i pavarur

# Rregullimi sipas stilit të vjetër (komando dhe kontrollo)

- Kompanitë energjetike – monopole në pronë shtetërore
- Qeveria miraton vendime të vogla operative
- Ministria sektoriale është pronar dhe rregullator
- Ndërmarrja në pronë shtetërore mbrohet nga konkurrenca por mund të mos lejohet që të mbulojë të gjitha kostot e veta
- Subvencionet dhe ndërsuvencionet lejohen dhe përkrahen politikisht

- Paraqitet me prezantimin e kapitalit privat
- Investuesit duan të sigurohen se do të mbrohen nga intervenimet qeveritare
- Rritet me liberalizimin e sektorit (shthurja, inicimi i konkurrencës)
- Rregullimi liberalizohet, sektori i privatizuar ka nevojë për vegla dhe qasje të reja

# Rregullatori kundrejt Ministrisë (1)



# Rregullatori kundrejt Ministrisë (2)

	Ministria	Rregullatori i pavarur	Autoriteti i konkurren.	Sistemi gjyqësor
Njohuri të specializuar	Nivel i lartë	Nivel i lartë	Nivel i ulët	Nivel shumë i ulët
Rreziku nga gllabërimi	Varet	Varet	Nivel i ulët	Nivel shumë i ulët
Shpejtësia në vendimmarrje	Nivel i lartë	Nivel i lartë	Nivel i ulët	Nivel shumë i ulët
Besueshmëria	Varet	Nivel i lartë	Nivel i ulët	Nivel i lartë

- **Mënyra e vjetër e rregullimit kryhej, krysisht, përmes**
  - Përcaktimit të çmimeve dhe standardeve teknike
  - Shfrytëzimit të pronësisë së mekanizëm kontrollues
- **Ishte i paqartë, jotransparent dhe i paparashikueshëm**
- **Qëllimi i mënyrës së re të rregullimit është**
  - Të inkurajojë konkurrencën (sipas mundësive)
  - Të rregullojë monopolet duke përdorur rregulla dhe mekanizma të qartë dhe transparentë

- Që të mbrojë investuesit nga rreziqet e papritura
- Që të mbrojë konsumatorët nga keqtrajtimi i fuqisë monopoliste
- Që të përcaktojë rregulla të qarta, transparente dhe stabile të lojës

## Pse të mbrohen investuesit?

- Kompanitë e shërbimeve publike kërkojnë shumë kapital dhe kanë asete që përdoren gjatë
- Investimet janë të mëdha dhe jomobile, dhe kanë periudha të gjata të kthimit të investimit
- Investuesit duhet të kenë rregulla të qarta të lojës
- Mosbesimi i investuesve zvogëlon kredibilitetin e shtetit dhe rritë koston e kapitalit


# Kushtet Kryesore për Rregullatorët

- Pavarësia
- Transparenca
- Përgjegjësia
  - apo më ndryshe, rregulla e tri A
- Autonomia
- Autoriteti
- Përgjegjësia (eng. Accountability)

- Jashtë strukturave ministrore
- Nuk kërkon miratim për
  - Ndryshim të tarifave
  - Dhënie të licencave
  - Zgjidhje të mosmarrëveshjeve
- Ndarje e qartë e roleve

- Të sigurojë se Qeveria do të veprojë me përkushtim ndaj konsumatorëve dhe investuesve
- Politikanët e kanë të vështirë t'i rezistojnë joshjes për t'i zbritur tarifat
- Rregullatorët e pavarur mund të përkushtohen asisoj që të fitojnë besimin e investuesve, ngase ata mbrohen më mirë nga presionet politike

- Bartja e fajit për vendime që nuk janë të preferuara nga popullata
- Lirimi nga detyrat e ndërlikuara teknikisht dhe të mërzitshme, të cilat sidoqoftë nuk janë joshëse për publikun
- Implementimi i politikave të BE-së
- Ofrohet mundësia për të demonstruar një përkushtim kredibil



- Emërimi i Komesarëve
  - Kushtet e lëkundshme
  - Krite të cilësisë
  - Kush bën emërimin
- Përfundim nga shërbimi civil?  
Normat qeveritare të pagave
- Financimi i agjencisë/Komisioni
  - Pagesat për licenca
  - Miratimi i buxhetit
- Largimi nga vendi i punës – vetë me shkak

- Asnjë agjenci qeveritare nuk është vërtetë e pavarur:
  - drejtimet politike të përgjithshme
  - ankesa (apeli)
  - buxheti
- Të zaptuar nga politikanët, industria dhe grupet tjera të interesit.

- Korniza ligjore është e pazhvilluar
- Politikat mbi konkurrencën nuk ekzistojnë
- Presionet politike dominojnë mbi faktorët ekonomikë dhe afaristë
- Ekziston ndarje e vogël e pushteteve politike, apo kjo ndarje nuk ekziston fare

# Kërcënimet kryesore për pavarësinë rregullative

- Në rast të rregullimit monopolist: konflikti i drejtpërdrejtë është me kompanitë e orientuara nga profiti
  - Gllabërimi
- Në rast të çmimeve të fryra: konflikti i drejtpërdrejtë është me politikën
  - çmimet e modifikuara / nën ndikim politik
- Resurset e pamjaftueshme – vendime jocalësore
  - Mungesë e zbatimit
  - Mungesë e informatave

# Përgjegjësia apo kush rregullon rregullatorin

- Vendimet merren pas diskutimeve të hapura
- Të gjitha palët janë të përfshira
- Vendimet dhe metodologjitë justifikohen nga rregullatori
- Në përgjithësi ka 'rregulla të qarta të lojës'

- Pjesëmarrja publike dhe transparencja
- Raportet vjetore dhe auditit
- Ankesa ndaj vendimeve vetëm në gjykatë
- Shqyrtimi i buxhetit
- Kodi i etikës
- Largimi nga pozita – vetëm me shkak

- Rregullatorët shpesh vëhen në dyshim – veçanërisht në ekonomitë tranzitore
- Shpesh veprimi i parë i rregullatorëve ka të bëjë me rritjen e çmimeve për të mbuluar koston
- Rregullatorët duhet të bindin publikun se rritjet shfaqen krahas eliminimit të subvencionimit dhe ndër-subvencionimit
- Të gjitha proceset duhet të jenë tejet transparente:
  - Metodologjitë të diskutohen gjatë dhe haptas
  - Vendimet të merren vetëm pasi të jenë konsultuar të gjitha palët e përfshira
  - Takimet të jenë të hapura për publikun, etj.

- Lëshimi, suspendimi, ndërrimi dhe revokimi i licencave
- Monitorimi i pajtueshmërisë me kërkesat e licencës
- Aprovimi i metodologjive të përcaktimit të çmimit dhe përcaktimi i çmimeve
- Zgjidhja e kontesteve mes akterëve të tregut
- Dhënia e dënimeve për shkak të mospajtueshmërisë, etj.

# Çfarë i mbetet ministrisë?

- Planifikimi dhe politikat e sektorit, përfshirë ristrukturimin
- Privatizimi
- Zhvillimi i një kornize ligjore
- Miratimi i investimeve të rëndësishme për sigurinë e shtetit
- Përkrahja e R&D

# Shfaqja dhe zhvillimi i rregullatorëve të energjisë në shtetet e BE-së

# Zhvillimi i institucioneve të rregullatorëve të energjisë në shtetet e BE-së

- Agjencitë e para rregullative janë themeluar në Britani të Madhe në fund të viteve të 80-a
- Kanë qenë të ndërlidhura me privatizimin dhe liberalizimin e sektorëve të gasit dhe energjisë elektrike
- Qasja e britanikëve ka qenë që të themelohet një agjenci në vend të komisionit (nga përvoja e SHBA-ve)
- Agjencitë apo komisionet janë themeluar në të gjitha shtetet e BE-së gjatë fundit të 90-ave dhe fillimit të milenuimit të ri (Gjermania paraqet përjashtim)
- Direktivat e BE-së për Energji Elektrike dhe Gas (2003) kërkojnë krijimin e një agjencioni të pavarur për rregullimin e sektorit të energjisë

## Autoritetet rregullative sipas Direktivës 2003/54/EC, duhet që së paku të

- Miratojnë apo korigjojnë së paku metodologjitë që shfrytëzohen për të përcaktuar kushtet për lidhje dhe qasje në rrjetet kombëtare
- Rregullojnë, në mënyrë të ngjashme, sigurimin e shërbimeve të baraspeshuara
- Kërkojnë nga TSO apo DSO të modifikojë kushtet apo termet, tarifat, rregullat, mekanizmat apo metodologjitë për lidhje dhe qasje në rrjet apo për shërbime të baraspeshuara
- Të veprojnë si arbitra, me efekt zbatues, në ankesat ndaj TSO apo DSO lidhur me çështjet e paracaktuara

**Direktiva përcakton aktivitetet e veçanta, sipas të cilave autoritetet rregullatore duhet të monitorojnë**

- Rregullat mbi menaxhimin dhe alokimin e kapacitetit ndërkonektues
- Mekanizmat për t'iu qasur mbingarkesës në rrjetet kombëtare
- Kohën që operatorëve të rrjetit u duhet për të kryer lidhjet dhe riparimet
- Publikimin e informatave të rrjetit
- Shturjen efektive të llogarive, për tu siguruar se nuk ka ndër-subvencionim,
- Etj.

## Rregullatorët e energjisë në BE – pavarësia

POLICY RESEARCH

- Shumica janë agjenci juridikisht të pavarura të cilat udhëhiqen nga një komision apo drejtor
- Disa nga rregullatorët janë vartës të ministrive të caktuara (Estonia, Finlanda, Gjermania, Greqia, Hungaria) apo kompanive të konkurrencës (Holanda)
- Vetëm në një numër të vogël shtetesh (Franca, Greqia, Spanja, Sllovenia) ministritë mund të miratojnë apo refuzojnë vendimet e rregullatorit
- Shumica e rregullatorëve nuk financohen nga buxheti shtetëror (përveç Gjermanisë, Francës, Finlandës, Danimarkës dhe shumicës së shteteve të reja anëtare)

# Rregullatorët e energjisë në BE – emërimi/shkarkimi

- Rregullatorët emërohen nga Parlamenti, Qeveria, Presidenti, Kryeministri, ndonjëherë nga ministrat (Estonia, Finlanda, Britania e Madhe, Irlanda, Holanda)
- Zakonisht ka kritere të caktuara
- Mandatet zgjasin 5-6 vjet (në Itali – 7 vjet), me mundësi të riemërimit (përveç në Itali dhe Francë)
- Largimi bëhet zakonisht vetëm me shkak (kushtet e përcaktuara me ligj)
- Por në disa vende edhe ministrat gjegjës mund të largojnë rregullatorin (Finlandë, Estoni, Britani e Madhe, Hollandë)

# Rregullatorët e Energjisë në BE – autorizimet e tyre

- Pothuajse të gjithë rregullatorët janë të autorizuar që të përcaktojnë tarifën e rrjetit (përveç në Francë, Greqi, Hungari, Spanjë dhe Slloveni)
- Më pak se gjysma e rregullatorëve kanë pushtet që të miratojnë legjislacion sekondar në fushën e tarifave
- Pothuajse të gjithë rregullatorët kanë autoritet mbi balancimin, shërbimet përcjellëse dhe përcaktimin e çmimeve për lidhje
- Vetëm rreth gjysma e rregullatorëve lëshojnë licenca, modifikojnë kushtet dhe imponojnë gjoba

- Politikanët nuk janë gjithmonë të kënaqur me faktin që rregullatorët marrin vendime të pavarura dhe u cenojnë atyre pushtetin
- Pavarësia e rregullatorëve kohëve të fundit është kufizuar përmes ndryshimeve legislative në Sllovaki, Poloni, Slloveni.
- Ekzistojnë shembuj të shumtë kur politikanë bënin presion ndaj rregullatorit për të marrë ndonjë vendim tjetër apo për të ndryshuar një vendim të marrë.
- Shumë shembuj kur rregullatorët janë ndërruar para përfundimit të mandatit (Hungari, Rumani, Sllovaki, Slloveni)

# Zhvillimi i mëtejshëm i agjencive rregullative në BE

## KE më 10 01 2007 ka identifikuar mangësitë vijuese

RE  
:H

- Çmimet e rregulluara që nuk lejojnë hyrjen në treg të akterëve të rinj
- Shturje jo të mjaftueshme të operatorëve të sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes, gjë që nuk mund të garantojë pavarësinë e tyre
- Qasje diskriminuese e palëve të treta në rrjet, në veçanti sa i përket qasjes preferenciale që i lejohet palëve me kontrata më të gjata nga e kaluara
- Kompetencat e pamjaftueshme të rregullatorëve

## KE ka tendencë që të ndër marrë veprime për të adresuar çështjet e mbetura në fushat vijuese

RE  
:H

- Sigurimi i qasjes pa diskriminim për rrjetet mirë të zhvilluara
- Përmirësimi i rregullimit të qasjes në rrjete në nivele kombëtare dhe të BE-së
- Zvogëlimi i fushëveprimit të konkurrencës jolojale
- Sigurimi i një kornize të qartë për investime
- Zgjidhja e çështjeve që kanë të bëjnë me ekonomitë familjare dhe konsumatorët më të vegjël afaristë

# Ngritja e nivelit të bashkëpunimit të rregullatorëve kombëtarë

- Themelimi i Agjencionit Evropian për bashkëpunim të rregullatorëve të energjisë (ACER)
- Detyrat kryesore të agjencisë
  - Sigurimi i një kornize për bashkëpunim mes rregullatorëve shtetërorë
  - Mbikëqyrja e bashkëpunimit mes operatorëve të sistemeve të transmisionit
  - Autorizime për vendime individuale që kanë të bëjnë me përjashtimin e kërkesave lidhur me asetet infrastrukturore me interes për Evropën
  - Rol të përgjithshëm këshillëdhënës vis-à-vis Komisionit, për sa i përket çështjeve lidhur me rregullimin e tregut

- monitorimin e pajtueshmërisë së operatorëve të sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes me rregullat e palëve të treta, obligimet mbi shthurjen, mekanizmat balancues, menaxhimin e tejngarkesës dhe ndërkoneksionit;
- rishqyrtimin e planeve investuese të operatorëve të sistemit të transmisionit, dhe sigurimi i vlerësimit mbi nivelin e konsistencës së planeve të investimit të operatorit të sistemit me planin zhvillimor 10-vjeçar në raportin vjetor;
- monitoimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit, dhe revizioni i rregullave mbi sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit;

**Komisioni propozon të fuziqohen autorizimet  
e rregullatorëve kombëtarë të tregut në  
(vazhdim)**

- monitorimin e obligimeve mbi transparencën;
- monitorimin e nivelit të hapjes dhe konkurrencës së tregut, dhe promovimi i konkurrencës efektive, në bashkëpunim me autoritetet e konkurrencës, dhe
- sigurimin se masat për mbrojtjen e konsumatorit janë efektive.

- Legjislacioni aktual kërkon nga autoritetet rregullative që të jenë plotësisht të pavarur nga intereset e industrisë së gasit dhe rrymës, megjithatë kjo nuk garanton pavarësi nga intereset afatshkurtra politike
- Propozohet që autoriteti rregullativ të jetë juridikisht i dalluar dhe funksionalisht i pavarur nga entitetet tjera publike e private, dhe që stafi dhe të gjithë pjesëtarët e organeve të veta vendimmarrëse të veprojnë në pavarësi nga intereset e tregut dhe të mos pranojnë udhëzime nga qeveria apo entitete tjera publike apo private
- Propozohet që autoritetet rregullative të kenë personalitet ligjor, autonomi buxhetore, resurse të duhura njerëzore dhe financiare dhe menaxhment të pavarur

# Shembuj

May 23, 2008

## Shembulli 1: Autoriteti rregullativ për Energji Elektrike dhe Gas në Itali

- Është themeluar sipas ligjit nr. 481 më 14 nëntor të vitit 1995
- Është plotësisht operative që nga 23 prilli 1997
- Entitet i pavarur me tre komisarë
- Përcakton organizimin e vet dhe procedurat për vendimmarrje
- Vetëfinancohet nga kontributet nga kompanitë dhe entitetet e rregulluara
- Anëtare e Këshillit Evropian të Rregullatorëve të Energjisë që nga 7 marsi i vitit 2000

- Caktimi i tarifave (niveli dhe çmimi maksimal) dhe monitorimi i çmimit
- Cilësia e shërbimeve (kërkesat minimale dhe sanksionet)
- Direktivat mbi shthurjen e aktiviteteve
- Këshilla mbi strukturën e tregut dhe promovimin e konkurrencës
- Mbikëqyrja e shërbimeve të furnizimit të energjisë elektrike dhe gasit dhe kontratave gjegjëse
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ankesave

## Shembulli 2: Organi rregullator në Greqi

- Ka pushtet shumë të limituar
- Ministri i Zhvillimit cakton tarifat e rrjetit
- Ministri cakton pagat e rregullatorëve dhe stafit të tyre
- RAE nuk ka kurrfarë roli në zgjidhjen e kontesteve ndërkufitare
- Shkurt, i mungon fuqia e një organi autonom
- Greqia ka mbetur prapa në implementimin e Direktivave të BE-së
- Trendi është negativ: është miratuar në vitin 2004 ligji që ndërprente mandatin e rregullatorëve (Profesori Capros dhe kolegët e tij janë larguar nga zyra)
- Burimi: raporti mbi standardizimin rregullativ për palët nënshkruese të Memorandumit të Athinës

- Në disa shtete (Irlandë, BM, Francë, Itali, Greqi, shtetet e reja anëtare) ekziston një histori e gjatë e monopoleve në pronë të shtetit
- Për të realizuar një liberalizim kredibil në këtë shtete, kërkohen rregullatorë me mandat të gjerë
- Shtetet nordike, Gjermania, Holanda kanë një sfond të ndryshëm me një industri me strukturë më të decentralizuar, me më pak pronësi shtetërore dhe me traditë të vetërregullimit
- Qasja ndaj rregullimit të tregut në këto vende është më pak ambicioze, duke përforcuar institucionet ekzistuese të cilat gradualisht modifikohen për tu përballë me situatën e ndryshueshme

- Rregullatori Estonez deri në vitin 2008 ishte agjenci në ministri
- Nuk ka buxhet të veçantë
- Por kishte fjalën e fundit sa i përket tarifave, licencave, zgjidhjes së kontesteve
- Ministria kurrë nuk ka sfiduar vendimet e Rregullatorit
- Komisioni Rregullativ për Energji i Gjeorgjisë është një Rregullator i pavarur dhe juridikisht i fuqishëm
- Pavarësia dhe funksionet e tij janë të përcaktuara me ligj
- Ka buxhet të pavarur
- Por në praktikë vepron si agjenci ministrore

- Korniza mirë e defincuar ligjore (me akte ligjore të përgjithshme dhe legjislacion sekondar)
- Ndarja e qartë e përgjegjësive me ministrinë
- Pranimi publik (nuk është lehtë i arritshëm pasi që një nga detyrat e para është ngritja e tarifave, largimi i subvencioneve)
- Menaxhim i përkushtuar (Komisionerët)

## JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJE!

---

REKK është themeluar në Universitetin Corvinus të Budapestit në dhjetor të vitit 2003. Misioni i REKK është që të kontribuojë në krijimin e tregjeve efektive të energjisë dhe themelimin e rregullatorëve efikas, përmes kryerjes së hulumtimeve aplikative, trajnimeve dhe këshillimeve kualitative për të gjitha palët e interesuara dhe organizatat aktive në këtë fushë.

Ne besojmë se përvojat në Hungari dhe disa shtete tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore në ristrukturim dhe ri-rregullim të tregjeve të energjisë janë të vlefshme dhe relevante për të gjitha ekonomitë në tranzicion. Për këtë arsye, Qendra ka për qëllim t'i vë theks hulumtimit dhe shpërndarjes së përvojave rajonale dhe mëton të jetë qendër rajonale hulumtuese e trajnuese.

**Adresa:**

Regionális Energiagazdasági Kutatóközpont (REKK)

1093 Budapest, Fővám tér 8.

Tel: +(36 1) 482 8971, Fax: +(36 1) 215 8894

Web: <http://rekk.bkae.hu>, E-mail: [vjankauskas@uni-corvinus.hu](mailto:vjankauskas@uni-corvinus.hu)